



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

VENDIM
Nr. 26, Datë 26.02.2025

“Për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm “Për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e ligjit për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës dhe nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, si dhe bazuar në përcaktimet e pikës VI të Vendimit nr. 50/2024, datë 30.05.2024, të Kuvendit të Shqipërisë “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Antikorrupsionin dhe Sundimin e Ligjit për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, në mbledhjen e datës 26/02/2025, pasi u shqyrtua ecuria e punës së Komisionit dhe u arsyetua nevoja për zgjatjen e afatit të veprimtarisë së tij, me propozim të Kryetarit, Komisioni i Posaçëm Parlamentar

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjatjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm, nga data e përfundimit të afatit të miratuar me vendimin nr. 50/2024, përkatësisht më 30 mars 2025, për një periudhë shtesë katër mujore, deri më 30 korrik 2025, me qëllim përmbushjen e objektivave të përcaktuara në vendimin e krijimit të tij.
2. Ky vendim, së bashku me kërkesën e arsyetuar, i paraqitet Konferencës së Kryetarëve për shqyrtim, e cila, në përputhje me procedurat e parashikuara në Rregulloren e Kuvendit, e përcjell për miratim në seancë plenare.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar më 26.02.2025

KRYETAR
FATMIR XHAFAJ